

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh.a. me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit H.S., kundër të paditurit N.P.T. "Bujari" me seli në Ferizaj, te cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor A.S., për shkak të borxhit në vlerë prej 672.60 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.213/14, të datës 06.05.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit N.P.T. "Bujari" me seli në Ferizaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.213/14, të datës 06.05.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Sh.a. me seli në Prishtinë. Nën paragrafin I të dispozitivit, ka detyruar të paditurin N.P.T. "Bujari" me seli në Ferizaj, që në emër të borxhit t'ia paguaj shumën prej 672.60 € (gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy euro e gjashtëdhjetë cent) në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Ndërsa nën paragrafin II të dispozitivit, gjykata e shkallës së parë e ka detyruar palët që shpenzimet t'i bartë secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i padituri për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar, që Gjykata e Apelit, të aprovojë ankesën e përfaqësuesit të të paditurit N.P.T. "Bujari", me seli në Ferizaj, si e bazuar dhe e ligjshme dhe të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, dhe lënda të dërgohet për procedim në procedim në Gjykatën Themelore-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil si gjykatë kompetente ose të aprovohet padia e paditësit në tërësi si e bazuar dhe e drejtë ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar ashtu që të refuzohet si e pabazuar padia e paditësit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, e paraqitur kundër të paditurit N.P.T. "Bujari", me seli në Ferizaj, për kërkesën në emër të borxhit prej 672,60 euro si dhe të detyrohet paditësi që të kompensoj të gjitha shpenzimet e kontestit për aq sa do të jenë ato.

Paditësi në përgjigje në ankesë ka propozuar që ankesa e të paditurit të hedhet poshtë me aktvendim nga gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi me datë 30.06.2009 ka parashtruar pranë gjykatës së shkallës së parë propozimin për lejimin e ekzekutimit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave, në shumën e përgjithshme prej 672.60 euro ndaj debitorit tani paditësit N.P.T “Bujari” me seli në Ferizaj. Me aktvendimin e E.nr. 1089/09 të dt.30.06.2009, ka lejuar përmbarrimin. Debitori më datë 21.12.2009 ka paraqitur kundërshtimin ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarrimit dhe mbi këtë bazë kjo çështje ka kaluar në procedurë kontestimore. Gjykata Themelore në Ferizaj me aktvendimin e datës 07.02.2014, është shpallur si gjykate jo kompetente dhe lëndën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti i Çështjeve Ekonomike në procedim të mëtutjeshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë, nga provat e administruara ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pasi i njëjti ka shfrytëzuar shërbimet telefonisë mobile të PTK-së, dhe se për këto shërbime të shfrytëzuara ka mbetur borxh shumën 672.60 euro.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 262 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar “kreditore në marrëdhënien detyrimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin në tërësi” prandaj duke u nisur nga fakti se i padituri me mospagimin e faturave jokontestuese i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, ka refuzuar ankesën dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet ankimore të paditurit lidhur parashkrimin në bazë të nenit 378 të LMD (1978) ligji në fuqi në kohën e lindjes së kërkesave të pretenduara, gjykata e shkallës së dytë i vlerësoi si të pabazuara për shkak se, ngase me nenin 180 par.3 të LPK-së është përcaktuar se “*Prapësimi i*

parashkrimit dhe prapësimit me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditurit lidhur me lidhur me kompetencën e Gjykatës Themelore Departamenti për Çështje Ekonomike, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. Në nenin 13 paragrafi 1 dhe 1.1 të Ligjit për Gjykatat nr.03/L-199 është përcaktuar “Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore është kompetent për kontestet ndërmjet personave juridik vendor dhe të huaj lidhur me çështjet e tyre afariste” dhe në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se kontrata për shërbime telefonike është e lidhur në emër të të paditurit, respektivisht N.P.T. ”Bujari”, me seli në Ferizaj në cilësinë e personit juridik.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.16/16, dt.24.02.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.